



Hapet Thirrja për Mobilitete (Bursa) Studentësh të UPT-së në kuadër të Marrëveshjes Erasmus+ , në Universitetin Teknologjik te Compiègne, France

Në kuadër të programit Erasmus + dhe marrëveshjes KA1 biletarale, është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për studentët të Universitetit Politeknik të Tiranës (UPT), Fakulteti i Teknologjise se Informacionit, në Universitetin Teknologjik te Compiègne (UTC), në Francë .

Nivelet e mobilitetit për studentët:

- **Bachelor** (studentët duhet të jenë të regjistruar në programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Informatike, Bachelor në Inxhinieri Elektronike dhe Bachelor në Inxhinieri Telekomunikacioni, në Universitetin Politeknik të Tiranës).
- **Master i Shkencave** (studentët duhet të jenë të regjistruar në programin e studimit Master i Shkencave ne Inxhinieri Informatike, Inxhinieri Elektronike, Inxhinieri Telekomunikacioni, në Universitetin Politeknik të Tiranës).

Kohëzgjatja e bursave:

- Numri i total i bursave/mobiliteteve ne dispozicion per kete thirrje, per nivelin Bachelor dhe Master i Shkencave se bashku eshte: 2 (dy) mobilitete (studente) , 6 muaj cdo mobilitet (nje semester).

Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët Bachelor dhe Master i Shkencave:

- CV;
- Foto personale;
- Kopje e Pasaportës;
- Listë notash të studimeve Bachelor deri në momentin e aplikimit (per studentet Bachelor);
- Listë notash e studimeve Master deri në momentin e aplikimit (per studentet Master i Shkencave);
- Diplomë e nivelit Bachelor (fotokopje, per studentet Master i Shkencave);
- Letër Motivimi (në gjuhën angleze ose franceze);
- Certifikatë e gjuhës franceze, niveli minimal i percaktuar B2 per aplikim ne UTC bachelor
- Certifikatë e gjuhës italiane, niveli minimal i percaktuar B2 per aplikim ne UNIGE bachelor
- Certifikatë e gjuhës angleze , niveli minimal i percaktuar B2 ;
- Dokumenti Learning Agreement (pasi te shpalleni fitues)*.

**Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë ‘‘Mobility Plan’’. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin Politeknik të Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Universitetin Teknologjik te Copmiegne (UTC), lëndë të njëjta ose ekuivalente me ato që do të kryeni në semestrin përkatës në fakultetin tuaj, kjo për arsye që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ata që do të zhvillohen në fakultetin tuaj semestrin përkatës, atëherë kur të ktheheni ju duhet të zhvillohen lëndët që nuk përshtaten në Universitetin Politeknik të Tiranës.



Dokumenti “Learning Agreement” tek seksioni “Commitment” firmoset nga aplikanti, nga koordinatori akademik i Fakultetit dhe nga Zv/Rektori i UPT-së për Anën Shkencore dhe Marrëdhëniet me Jashtë.

Afati për aplikim për studentët: deri më 22 Nentor 2021

Aplikimi kryhet pranë zyrës së Projekteve ne fakultetin e Teknologjise se Informacionit ne Dekanat . Dokumentat e cituara ne sipër duhet te dorezohen ne hard copy te firmosura dhe te nisen edhe elektronikisht me email ne adresen e email: sbylyku@fti.edu.al

Për informacione shtesë në lidhje me procesin e aplikimit mund të kontaktoni në email: ekajo@fti.edu.al

Për më shumë informacion mbi UTC, France mund të kontaktoni me personin e kontaktit:
Prof. Dritan Nace, email: dritan.nace@hds.utc.fr

DEKANATI